



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1103/Prot.
5

Tiranë, më 11/10/2017

VENDIM

Nr. 93, datë 11/10/2017

Në mbështetje të pikës 1/b, 3 dhe 4 të nenit 21, të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (këtej e tutje K.SH.H) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1103 Prot., datë 11.08.2017, ndaj Organit Publik/Bashkia Tiranë (më tej, organi publik), me objekt “Ankim lidhur me cenimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për propozimin për rritjen e çmimit të ujit dhe miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak Tiranë”.

Lidhur me objektin e ankesës, vërehet se akti ndaj të cilit ankohet ankuesi, *Vendimi Nr.79, datë 26.07.2017*, shpreh vullnetin e organit publik (në këtë rast organ i pushtetit vendor - Këshilli Bashkiak Tiranë). Vendimi i lartpërmendur, ka të bëjë me dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, propozim i dalë nga hartimi i *Planit të Biznesit 5 vjeçar* të Ujësjellës Kanalizime Tiranë dhe nga analizat kosto-përfitim që ky plan Biznesi realizoi. Si rrjedhojë, *kemi të bëjmë me një politikë me interes të lartë publik* që ka rezultuar si nevojë e përmbushjes së një plani strategjik.

Sipas ankuesit, nga organi publik nuk janë zbatuar nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, detyrime të cilat janë bërë të zbatueshme që me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Ankuesi konstaton se nga konsultimi në faqen zyrtare on-line të Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), rezulton se, Bashkia Tiranë nuk figuron në listën e institucioneve publike që janë të detyruara që të marrin masat e nevojshme për të krijuar mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Aq më pak, vijon ankuesi, që në regjistrat nuk gjendet i publikuar “Vendimi për dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm”.

Ankuesi i referohet edhe Programit të Transparencës së Bashkisë së Tiranës, në të cilin, në rubrikën e konsultimit publik nuk rezulton të jetë publikuar plani vjetor i

organit publik që lidhet me procesin e vendimmarrjes. Ankuesi vijon se për shkak të mungesës së publikimit të projekt-aktit në RENJK, mungon marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij për rrjedhojë edhe pjesëmarrja në procesin e konsultimit nga ana e palëve të interesuara.

Pas vlerësimit të ankesës së K.SH.H në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr.146/2014 në të cilin citohet se *"...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 10 ditëve"*, Komisioneri me shkresën Nr. 1103/1 Prot., datë 29.08.2017, ka kërkuar nga organi publik të paraqesë parashtrime me shkrim brenda këtij afati.

Në përgjigje, pranë Zyrës së Komisionerit janë dërguar parashtrime (shkresa Nr. 1103/3 Prot., datë 26.09.2017) nga Organi publik-Bashkia Tiranë dhe nga Ujësjellës Kanalizime Tirana sh.a, (shkresa Nr. 1103/2 Prot., datë 20.09.2017):

- Këshilli Bashkiak Tiranë, në cilësinë e zotëruesit të shumicës së aksioneve të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tirana (UKT) sh.a dhe në respektim të plotë të kuadrit ligjor të sektorit të furnizimit me ujë, ka shprehur opinionin e tij *për ti propozuar Entit Rregullator të Ujit rritjen e tarifës së ujit, i cili është edhe organi vendimmarrës që vendos miratimin apo mosmiratimin përfundimtar të këtij propozimi.*
- Bashkia Tiranë ka organizuar konsultimin publik me individët, grupet e interesit dhe palët e interesuara duke dëgjuar ankesat, kërkesat e tyre dhe duke parashtruar objektivisht argumentimet teknike dhe ekonomike që kanë çuar në këtë propozim, si dhe duke përjashtuar nga ky propozim pensionistët dhe familjet në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike.
- UKT me datë 16.06.2017 ka publikuar në faqen zyrtare web dokumentacionin e plotë për ndryshimin e tarifës.
- UKT ka realizuar seancë dëgjimore për publikun në datë 27.07.2017, *(Dërguar bashkëlidhur parashtrimeve në DVD dhe hardcopy.)*
- Kryetari i Bashkisë ka bërë publike njoftimin për seancën dëgjimore në faqen zyrtare web www.ujesjellestetirane.al si dhe në gazetën Dita.
- Për sa i përket transparencës së këtij procesi para vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Tiranë dihet botërisht se Kryetari i Bashkisë Tiranë ka sqaruar publikisht në lajme dhe në emisione televizive të gjithë procesin dhe argumentet tekniko-ekonomike që kanë sjellë si domosdoshmëri rritjen e tarifës së ujit të pijshëm.
- Dokumentacioni për rritjen e tarifës së ujit dhe kanalizimeve për Tiranën është publikuar në faqen zyrtare të UKT sh.a para miratimit nga Asambleja e Aksionarëve. Gjithashtu këto akte janë bërë të njohur nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive nga Bashkia Tiranë dhe UKT sh.a deri në organizimin e seancës dëgjimore.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të nenit 21/3 të Ligjit nr. 146/2014 *"Për njoftimin dhe konsultimin publik"*, në të cilin citohet *"...Komisioneri kur e sheh të përshtatshme organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"*, me shkresën nr.1103/4, datë 03.10.2017 janë njoftuar përfaqësuesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Bashkisë së Tiranës, Entit Rregullator të Ujit si dhe të Ujësjellës

Kanalizime Tiranë për t'u paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit me datë 09.10.2017 ora 12:00, për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tyre.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e ankuesit/K.SH.H, i qëndruan pretendimeve të ngritura në ankesë. Ankuesi citoi ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht pikën 1 të nenit 23, ku parashikohet se: *Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1.Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.* Gjithashtu ankuesi vijoi, me nenin 7, 8 dhe 9 të ligjit të sipërpërmendur, në të cilat parashikohet se organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave, por edhe vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankuesi nisur nga sa parashtroi dhe shprehu në seancë dëgjimore, nënvizoi faktin që propozimi i Ujësjetllës Kanalizime Tiranë ka marrë fuqi juridike me *Vendimin Nr.79, datë 26.07.2017* të Këshillit Bashkiak.

Ndërsa, përfaqësuesit e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë pranuan se kanë ndjekur hapat dhe procedurat për konsultimin dhe marrjen e mendimeve të këtij propozimi, objekt i këtij procesi administrativ dhe parashtruan se vendimi përfundimtar për rritjen e çmimit të ujit është atribut i Entit Rregullator të Ujit (ERRU). Ata theksuan se vendimin e Këshillit Bashkiak e kanë konsultuar në një seancë dëgjimore datë, 27.07.2017, pas miratimit të tij.

Sipas përfaqësuesve të ERRU, puna, roli dhe kompetencat ushtrohen bazuar në ligjin nr.8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Në shpjegimet e tyre, ERRU konfirmoi se veprimtaria e njoftimit dhe konsultimit me publikun, mbështetet në "Udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave", miratuar me Vendimin e Komisionit nr.37, datë 06.09.2017, në të cilin është parashikuar zbatimi i ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", neni 6 "Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik".

Lidhur me objektin e ankesës, përfaqësuesit e ERRU sqaruan se janë në proces vlerësimi të këtij propozimi i cili do të vijojë me vendimmarrje kolegjiale nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU, në zbatim të parashikimeve ligjore të bëra në nenin 14/1/b dhe 22/2 të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996.

Bashkia Tiranë dhe UKT në këtë proces ndër parashtrimet e tyre dhe përgjigjet e dhëna pas pyetjeve të drejtuara nga Komisioneri dhe K.SH.H, pranuan se kanë zhvilluar seanca dëgjimore apo edhe kanë përdorur mjete të tjera njoftimi, por nuk kanë zbatuar detyrimet e parashikuara në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, konkretisht kërkesat ligjore të nenit 6 të këtij ligji, sipas të cilit domosdoshëmrishit kërkohet hedhja në regjistrin elektronik të projekt-aktit.

Komisioneri vlerëson rëndësinë e promovimit të transparencës dhe zbatimit të kuadrit ligjor për zbatimin e të gjithë hapave që ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" parashikon.

Çdo organ publik gjatë fazës së njoftimit dhe konsultimit duhet të zbatojë detyrimet kryesore të parashikuara në nenin 6 dhe 7 të ligjit 146/2014, "...publikimit në regjistrin elektronik të projektaktit..." e duke vazhduar me masat vijuese, si afatet kohore (neni 15 i ligjit), për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve, etj.

Parashikimet e mësipërme janë disa detyrime ligjore të cilat përcaktojnë rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Ligji 146/2014 në gërmën b) të pikës 1 të nenit 21 parashikon se: Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cënuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen: *b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.*

Për sa më sipër, Komisioneri nga njohja me faktet dhe provat e paraqitura nga palët në këtë proces administrativ, konstaton se ndryshimi i nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nuk është miratuar ende. Në kushte të tilla, palët e interesuara mund të ankohen pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Nën këtë argumentim, ankuesi në këtë proces administrativ nuk gjendet përpara zbatimit të gërmës “b” të pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr.146/2014.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

V E N D O S A:

1. Deklarimin e moskompetencës lidhur me ankesën nr. 1103 Prot., datë 11.08.2017 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit kundër Organit publik/Bashkia Tiranë me objekt “Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për propozimin për rritjen e çmimit të ujit dhe miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak Tiranë”, për shkak se projektakti për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nuk është miratuar ende.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
3. Ky vendim u shpall sot me datë 11.10.2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

